

## Operacionet e suksesshme

### INTERPOL


- Në vitin 2012, niveli i mirë i bashkëpunimit brenda kornizave të INTERPOL-it ndërmjet EULEX-it dhe autoriteteve përkatëse ligj-zbatuese në Austri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, Gjermani, Itali dhe Slloveni çoi në arrestimin e 18 të dyshuarve, të akuzuar për krim të organizuar dhe kontrabandë emigrantësh. Dy prej tyre ishin shqiptarë të Kosovës, që u arrestuan në Kosovë nga një ekip i përbashkët hetimor i EULEX-it dhe Policisë së Kosovës.

### EUROPOL

- Më 29 janar 2013, 10 vende evropiane dhe EULEX-i u përfshinë në një aksion të përbashkët të mbështetur dhe koordinuar nga EUROPOL-i, i cili rezultoi me arrestimin e 103 personave të dyshuar si pjesë e një rrjeti të kontrabandimit të njerëzve. Në të njëjtën ditë, në kuadër të këtij aksioni të përbashkët mbarëevropian, në Kosovë u arrestuan edhe tre persona; 12 të tjerë pjesë e të njëjtit rrjet kriminal ishin arrestuar tashmë në Kosovë në vitet 2011 dhe 2012.
- “Operacioni i Përbashkët Policor Europe 2013” i udhëhequr nga Italia dhe i mbështetur nga EUROPOL-i, i cili rezultoi në sekuestrimin e 129 automjeteve të vjedhura me një vlerë të vlerësuar prej gati 2 milionë eurosh, u bë me pjesëmarrjen e autoriteteve ligj-zbatuese nga Shqipëria, Austria, Belgjika, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Gjermania, Hungaria, Italia, Kosova, Moldavia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Rumania, Serbia, Sllovenia dhe Mbretëria e Bashkuar, si dhe me pjesëmarrjen e EULEX-it, Eurojust-it, Frontex-it dhe INTERPOL-it.
- Më 21 mars 2018, Sllovenia, Kosova, EULEX-i dhe EUROPOL-i punuan së bashku për arrestimin e 12 kontrabanduesve të emigrantëve që vepronin në Ballkan, tetë prej të cilëve në Kosovë.
- Në mars të vitit 2021, pas një kërkesë të Policisë së Kosovës, EULEX-i e lehtësoi shkëmbimin e informacioneve përmes EUROPOL-it për një operacion të përbashkët të madh të kryer nga EUROPOL-i, Shqipëria dhe disa shtete anëtare të BE-së që kishte për cak dy grupe të krimit të organizuar që merreshin me trafikimin e qenieve njerëzore dhe falsifikimin e dokumenteve.

### Protokolli për Bashkëpunimin Policor ndërmjet EULEX-it dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë

- Më 27 mars 2020, Policia e Serbisë kërkoi nga EULEX-i që të verifikonte me Policinë e Kosovës nëse një person i zhdukur që udhëtonte nga Kosova për në Serbi ishte arrestuar apo pranuar në ndonjë spital në Kosovë. Policia e Kosovës u përgjigj menjëherë duke thënë se kontrollet e bëra në burgje, spitale dhe në të gjitha qendrat e karantinimit për COVID-19 ishin negative. Në të njëjtën ditë, vetura e personit të zhdukur është gjetur në një fshat afër një pikë-kalimi të përbashkët me Serbinë dhe më 3 maj 2020 personi i zhdukur është gjetur i vdekur. Gjatë gjithë këtij operacioni, bashkëpunimi mes dy agjencive ligj-zbatuese ka qenë i shkëlqyer.
- Më 23 mars 2021, EULEX-i e lehtësoi kthimin e pajisjeve të konfiskuara në Policinë e Kosovës, duke përfshirë një automjet, armët personale dhe pajisje të tjera policore. Pajisjet ishin konfiskuar në mars të vitit 2012 kur policët serbë i arrestuan dy policë të Kosovës, të cilët u liruan më vonë.
- Më 28 maj 2021, një shtetas serb 31 vjeçar, i cili po udhëtonte me motoçikletë nga Beogradi, Serbi për në Graçanicë, Kosovë u zhduk. Të nesërmen, autoritetet serbe i dërguan një kërkesë urgjente EULEX-it duke kërkuar hetim për vendndodhjen e personit të zhdukur. Më 30 maj 2021, personi u gjet i gjallë në një greminë. Pjesëtarët e Njësisë Policore të Specializuar të EULEX-it, të cilët ishin në patrullim vëzhgues, i dhanë ndihmën e parë të lënduarit, i cili më pas u transferua në spital. Më 14 qershor 2021, autoritetet serbe i dërguan një mesazh urgjent EULEX-it duke thënë se një person mashkull kishte shkuar në një fshat në Serbi dhe e kishte përdhunuar një vajzë 14-vjeçare në mënyrë që të martohej me të. Më 15 qershor 2021, Policia e Kosovës ka hyrë në shtëpinë e të dyshuarit, ku janë gjetur autori dhe viktimja e mitur e zhdukur. I dyshuari dhe viktimja janë shoqëruar në stacionin policor dhe me urdhër të Prokurorit të Shtetit i dyshuari është ndaluar në mbajtje për 48 orë. Rasti u cilësua si përdhunim, kurse viktimja e mitur u vendos në një strehimore për viktimat e dhunës në baza gjinore.



# Bashkëpunimi Policor Ndërkombëtar me pak fjalë



## Si funksionon shkëmbimi i informacioneve?

- 1) Ndërmjet Kosovës dhe vendeve të ndryshme, ai bazohet në marrëveshjet dypalëshe për bashkëpunimin policor.
- 2) Ndërmjet Policisë së Kosovës dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, ai lehtësohet përmes EULEX-it në bazë të Protokollit për Bashkëpunimin Policor ndërmjet EULEX-it dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë.
- 3) Ndërmjet Policisë së Kosovës dhe EUROPOL-it, ai lehtësohet përmes zyrës suedeze EUROPOL-SIENA të drejtuar nga EULEX-i. Më 28 korrik 2020, ka hyrë në fuqi një Marrëveshje Pune që i përcakton marrëdhëniet për bashkëpunim ndërmjet autoriteteve ligj-zbatuese të Kosovës dhe EUROPOL-it. Në shtator 2021, Kosova ka paralajmëruar që së shpejti do ta caktojë një Zyrar Ndërlidhës në EUROPOL. Kjo Marrëveshje Pune do ta përforcojë shumë bashkëpunimin e drejtpërdrejtë ndërmjet Kosovës dhe EUROPOL-it.
- 4) Ndërmjet Policisë së Kosovës dhe Zyrave Qendrore Kombëtare të INTERPOL-it, ai lehtësohet përmes Zyrës Ndërlidhëse me Interpolin në kuadër të UNMIK-ut. Ekspertët e EULEX-it janë pjesë e Zyrës Ndërlidhëse të UNMIK-ut me Interpolin.

## Pse është i rëndësishëm bashkëpunimi policor ndërkombëtar?

Falë mekanizmave të bashkëpunimit policor ndërkombëtar, të dhënat e besueshme janë në dispozicion me kohë, gjë që u mundëson autoriteteve ligj-zbatuese që të:

- parandalojnë dhe luftojnë krimet e organizuara, terrorizmin dhe format tjera të krimeve të rënda;
- hetojnë krimet e rënda dhe të organizuara, krimet ndër-kufitare dhe format tjera të krimeve të rënda;
- arrestojnë ndonjë kriminel;
- zgjidhin krimet me dimension ndërkombëtar;
- shkëmbejnë të dhëna kriminale dhe të inteligjencës me vendet tjera.

## Cili është roli i EULEX-it?

EULEX-i e mbështet Policinë e Kosovës në fushën e bashkëpunimit policor ndërkombëtar duke e lehtësuar shkëmbimin e informacioneve ndërmjet Policisë së Kosovës dhe INTERPOL-it, EUROPOL-it apo Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë përmes kanaleve të sigurta. Nga viti 2008 deri në qershor 2018, ky bashkëpunim ka rezultuar në më shumë se 100 arrestime.

EULEX-i ka organizuar kurse trajnimi për ngritjen e kapaciteteve dhe vizita studimore për përfaqësuesit e Policisë së Kosovës.

## Numri i kërkesave të pranuar dhe të dërguara nga EULEX-i nga viti 2017 deri në vitin 2022:

	Kanali i INTERPOL-it	Kanali i EUROPOL-it	Protokolli ndërmjet EULEX-it dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë
2017	2241	117	239
2018	1717	115	208
2019	2740	292	281
2020	1760	340	702
2021	1360	655	929
2022	1886	243	598

## Kurset e trajnimit dhe vizitat e organizuara nga EULEX-i

- 2015 ▶ Trajnim për personelin e Njesisë Koordinuese për Zbatimin e Ligjit Ndërkombëtar (ILECU) të Policisë së Kosovës për standardet e INTERPOL-it dhe EUROPOL-it për komunikim dhe rregullat dhe rregulloret përkatëse.
- 2016 ▶ Punëtori për personelin e Doganës së Kosovës dhe Policisë së Kosovës për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të mallrave të paligjshme.
- 2016 ▶ Sesion trajnues për Policinë e Kosovës lidhur me instrumentat dhe kanalet e bashkëpunimit policor ndërkombëtar.
- 2016 ▶ Trajnim mbi standardet e INTERPOL-it dhe EUROPOL-it për komunikimin, çështjet e mbrojtjes së të dhënave dhe rregullat dhe rregulloret që i rregullojnë aktivitetet operacionale të Zyrës Qendrore Kombëtare.
- 2016 ▶ Vizitë studimore e përfaqësuesve të ILECU në Zyrën Qendrore Kombëtare të INTERPOL-it të Athinës, Greqi.
- 2017 ▶ Vizitë studimore për përfaqësuesit e ILECU në selinë e EUROPOL-it në Hagë, Holandë.
- 2018 ▶ Trajnim për përfaqësuesit e ILECU për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në Romë, Itali.
- 2018 ▶ Vizitë studimore për përfaqësuesit e Policisë së Kosovës në Zyrën Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF) në Bruksel, Belgjikë.
- 2019 ▶ Trajnim mbi parimet e bashkëpunimit policor ndërkombëtar për përfaqësuesit e Policisë së Kosovës në Shërbimin e Inteligjencës Kriminale në Austri.
- 2019 ▶ Punëtori për zyrtarët e Policisë së Kosovës për luftimin e krimeve mjedisore.
- 2019 ▶ Vizitë studimore për përfaqësues të Policisë së Kosovës në Komandën e Karabinierëve Italianë për Mbrojtjen e Mjedisit në Romë, Itali.
- 2021 ▶ Takime të ekspertëve të EUROPOL-it me përfaqësues të Policisë së Kosovës dhe Agjencisë Kosovare të Mjekësisë Ligjore lidhur me atë se si mund ta mbështesë EUROPOL-i Kosovën në luftën e saj kundër falsifikimit të monedhave.